



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

01Nr. 08-320-40509/2015  
Kaçanik, 30.11.2015

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale ( Gazeta Zyrtare 28/2008) lidhur me nenet, 16 pika 4 (b), 19.1 dhe 19.2 të Ligjit Nr. 02/L-53 - Për Gjuetinë, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 30.11.2015, merr këtë:

### V E N D I M

#### **PËR THEMELIMIN E VENDGJUETIVE TË PËRBASHKËTA “LYBETENI” NË TERRITORIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT**

1. Me këtë Vendim themelohen **VENDGJUETITË E PËRBASHKËTA “LYBETENI”** në territorin e komunës së Kaçanikut, me sipërfaqe të përgjithshme prej 21.126 ha dhe me sipërfaqe prej 18.409 ha, ku mund të kryhen aktivitetet të gjuetisë, duke respektuar në përpikëri vendet e ndaluara për gjueti të përcaktuara si në nenin 24 të Ligjit për Gjuetinë.
2. Pronat publike dhe ato private të sipërfaqes së përcaktuar si në pikën I. të këtij Vendimi, janë paraqitur në formë tabelare në: ANEKSIN 2 me emrin : “Pasqyra e Sipërfaqeve” që është pjesë përbërse e këtij Vendimi. Pjesë përbërse e këtij Vendimi është edhe Lista e kafshëve të egra, të përcaktuara në ANEKSI 3 - pjesë e planit vjetor të menaxhimit terreneve të VendGjuetive.
3. Vengjuetitë e përcaktuar si në pikën I. të këtij Vendimi, kufizohen:
  - 3.1. Në pjesën jugore kufizohet me Hanin e Elezit dhe brezin kufitar me Maqedoninë,
  - 3.2. Në pjesën lindore me komunën e Vitisë,
  - 3.3. Në veri me komunën e Ferizajt,
  - 3.4. Në Perendim me komunën e Shterpcës, dhe vijën kufitare me Maqedoninë.
4. Themelimi i Vendgjetive të Përbashkëta në territorin e komunës së Kaçanikut është në pajtim me planet ekzistuese hapësinore.
5. Shoqata e Gjahtarëve “Dreri” në Kaçanik e themeluar sipas ligjeve paraprake, do të vazhdoj të menagjoj me Vendgjuetitë e Përbashkëta, duke respektuar dispozitat e Ligjit për Gjuetinë dhe çdo Akt tjetër Juridik që është në fuqi e që kanë të bëjnë me këtë lëmi, përderisa komuna e Kaçanikut të përfundoj procedurat e përcaktuara me Ligjin për Gjuetinë dhe për dhënjën e vendgjuetive të përbashkëta në menagjim.
6. Ky vendim pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante, dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
**Xhelal Gashi**